



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIT**

1. **Drejtuar: Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ADDON” shpk & “BLERIMI” shpk.**
2. **Adresa:** Tiranë, Rr. “Memo Meto”, Pallati 59/7, Apartamenti 9
Adresa: Elbasan, Shirgjan, Mjekes, Fshati Mjekes, Zona Topcias, Rr. Elbasan-Cerrik, Km.4
3. **OE/BOE me nënkontraktor**
PO ☐ **JO** ☒
4. **OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**
PO ☐ **JO** ☒
5. Tipi i Kontratës: Punime ndërtimi
6. Lloji i Procedurës së prokurimit: **“Procedurë e Hapur”**
7. Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF- 90587-06-19-2026**
8. Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rikualifikim i territorit që kufizohet nga rruga “Dibrës” – “5 Maji” – “Ferit Xhajko” – “Gjon Buzuku”.**
9. Fondi limit: **91,863,394.81** (nëntëdhjetë e një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.
10. **Burimi i financimit:** me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2026, miratuar me VKB Nr.100, datë 18.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026” të miratuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. Prot 43563/1., datë 29.12.2025”.
11. Kohëzgjatja e kontratës: 8 (tetë) muaj kalendarik.
12. Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 22.06.2026
13. Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr.41, datë 29.06.2026.
14. **KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**
 - oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
 - oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “MELA.” shpk

Vlera: **0 (zero)**lekë pa TVSH

2. Operatori Ekonomik “RSM COMPANY” shpk

NUIS 810802422

Vlera: **56,877,372.50** (pesëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH

3. Operatori Ekonomik “NIKA” shpk

NUIS J76705047U

Vlera: **57,862,207** (pesëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik “2 N” shpk

NUIS L31615017L

Vlera: **59,550,841** (pesëdhjetë e nëntë mil) lekë pa TVSH.

5. Operatori Ekonomik “ALBAVIA” shpk

NUIS J81527001Q

Vlera: **60,006,399.20** (gjashtëdhjetë milion e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë njëzet) lekë pa TVSH

6. Operatori Ekonomik “LIS KONSTRUKSION” shpk

NUIS K66613407H

Vlera: **61,691,530.70** (gjashtëdhjetë e një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

7. Operatori Ekonomik “VELLEZERIT HYSA” shpk

NUIS K12911201C

Vlera: **63,819,934.03** (gjashtëdhjetë e tre milion e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër pikë zero tre) lekë pa TVSH.

8. Operatori Ekonomik “PEPA GROUP GROUP” shpk

NUIS L42215009L

Vlera: **65,959,934.13** (gjashtëdhjetë e pesë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind tridhjetë e katër pike trembëdhjetë) lekë pa TVSH

9. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ADDON” shpk & “BLERIMI” shpk

NUIS L32014007G & J62903384G

Vlera: **67,645,507.50** (gjashtëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH

10. Operatori Ekonomik “PE – VLA - KU” shpk

NUIS K61716013M

Vlera: **67,942,796.40** (gjashtëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e dyzet e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë dyzet) lekë pa TVSH

11. Operatori Ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” shpk

NUIS K81716011V

Vlera: **68,418,654** (gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH

12. Operatori Ekonomik “BE - IS” shpk

NUIS K71412003A

Vlera: **68,460,341** (gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e dyzet e një) lekë pa TVSH.

13. Operatori Ekonomik “MARVELS”S Construction Group SHPK

NUIS J77506312B

Vlera: **74,783,614** (shtatëdhjetë e katër milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e katërmëdhjetë) lekë pa TVSH

14. Operatori Ekonomik “CURRI” shpk

NUIS J67902718S

Vlera: **74,796,040.45** (shtatëdhjetë e katër milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyzet pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

15. Operatori Ekonomik “LIQENI VII” shpk

NUIS K01730502W

Vlera: **84,279,595.50** (tetëdhjetë e katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë pike pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “MELA.”shpk

Operatori ekonomik “Mela” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 1, germa b) Ofertuesi duhet të paraqesë: Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve rezulton se operatori ekonomik “Mela” shpk nuk ka paraqitur Sigurimin e ofertës.

Operatori ekonomik “Mela” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 1, germa a) Ofertuesi duhet të paraqesë: Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve rezulton se operatori ekonomik “Mela” shpk nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik “Mela” shpk nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, Kushtet e Përgjithshme të Përzgjedhjes/kualifikimit, Kushtet e Vecanta të Kualifikimit shtojca 7, ku përcaktohet se: “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit”. “Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit u konstatua se operatori ekonomik “Mela” shpk nuk ka paraqitur Formularin e Ofertës, Shtojca 1 si dhe shtojca 2 “Lista e Çmimeve” sipas zërave të preventivit.

2. Operatori ekonomik “RSM COMPANY”shpk

Operatori ekonomik “RSM Company” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.10 ku është kërkuar “Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: -1 (një) punonjës i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialeve ose Operatori Ekonomik...”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “RSM

Company” shpk është mbështetur te subjekti mbështetës “ED KONSTRUKSION” Shpk për 1 (një) Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve te Ndërtimit /Inxhinier Materialesh, duke u mbështetur në më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 90, pika 2, paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *“Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”*. Operatori ekonomik “RSM Company” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.16, ku përcaktohet: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) Eskavator me goma, 1, copw”* gjërma (f) ku përcaktohet; *“Për mjetet që sipas përcaktimeve ligjore te qarkullimit rrugor nevojitet targa, leje qarkullimi...etj. Operatori ekonomik duhet te deklaroje në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në rubriken përkatëse të dhënat për mjetet e kërkuara në shtojcën 8....”*. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “RSM Company” shpk në përmbushje të kërkesës për disponimin e mjeteve me qera apo në pronësi, për mjetin Eskavator me goma nuk ka deklaruar targat sipas formatit të kërkuar në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimi, Deklaratën C, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.16, të Kapacitetit Teknik, Kriteret të Veçanta të Kualifikimit, të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

3. Operatori Ekonomik “NIKA” shpk

Operatori ekonomik “NIKA” shpk nuk përmbush Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.10 ku është kërkuar “Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: -1 (një) punonjës i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve te Ndërtimit /Inxhinier Materialesh ose Operatori Ekonomik...”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “NIKA” shpk është mbështetur te subjekti mbështetës “MANE/S” Shpk për 1 (një) Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve te Ndërtimit /Inxhinier Materialesh, duke u mbështetur në më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 90, pika 2, paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *“Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”*.

Operatori ekonomik “NIKA” shpk nuk përmbush Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.10 ku është kërkuar “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë: 1- Teknik Elektrik”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “NIKA” shpk është mbështetur te subjekti mbështetës “MANE/S” Shpk për 1 (një) Teknik Elektrik, duke u mbështetur në më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 90, pika 2, paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *“Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”*.

4. Operatori Ekonomik “ALBAVIA” shpk.

Operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.10, ku është kërkuar” Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë: - 1 (një) Teknik Elektrik”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk ka deklaruar të njëjtin punonjës iniciale H. GJ, në rolin e punonjësit Inxhinierit Elektrik edhe në rolin e punonjësit Teknik Elektrik, çka bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.5 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit ku përcaktohet se: “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht: - 1 (një) Inxhinier Elektrik” si dhe pikën 2.3.10 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, si më poshtë: - 1 (një) Teknik Elektrik”.

5. Operatori Ekonomik “LIS KONSTRUKSION” shpk

Operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...” Eskavator me goma cope 1, Fadrome cope 1, Asfaltoshtruese cope 1, Autobetonere cope 2...gërma g) ku përcaktohet se: “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit te cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” shpk ka deklaruar mjetet Eskavator me goma me targë AEMT 38, Fadromë ANMT 61, Asfaltoshtruese me Fat Nr 5/2023, Asfaltoshtruese me Fat Nr 28 Autobetoniere kantieri Fat R 96477 , Autobetoniere kantieri Fat R 40962 , Autobot uji me targë AA030VF Greider me targë AEMT43,etj , mjete të cilat rezultojnë të angazhuara në kontratën me objekt: “Rehabilitimi I Infrastruktures rrugore ne Njësinë Administrative 4 + 8 + 12”, me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” shpk ka deklaruar mjetet Eskavator me goma me targë AEMT 38, Kamion me targë AB614AY, Asfaltoshtruese me Fat Nr 5/2023, Autobetoniere kantieri Fat R 96477, Autobetoniere kantieri Fat R 40962, Greider me targë AEMT43, Asfaltoshtruese me Fat Nr 28. Autobot uji me targë AA030VF...etj, mjete të cilat rezultojnë të angazhuara në kontratën me objekt: “Rikualifikim urban i bllokut te kufizuar nga rruget: Sami Frasheri - Pjeter Bogdani - Andon Zako Cajupi dhe Moskat”, me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare”.

6. Operatori Ekonomik “2 N” shpk

Operatori ekonomik “2N” Shpk shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”:

Rrul me (Kompresor me vibrim) copë 2, Asfaltoshtruese copë 2, Grejder copë 2, Autobitumatriçe copë 2, Kamion me kapacitet 3-5 ton copë 1, Autobot uji copë 1, Eskavator me goma copë 1, Kamion me kapacitet 10-20 ton copë 2..etj gërma g) ku përcaktohet se: “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “2N” shpk ka deklaruar mjetet Rrul (Kompresor me vibrim) me Nr. Fature 29/2024 datë 02.05.2024, Asfaltoshtruese Nr. Rep: 8779 Nr. Kol:4190, Grejder me nr shasie 28006610, Autobitumatriçe me targë AA506PU, Autobot Uji me targë AA264TV, Kamion me targë AA561UV, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me object: “Ndertim i rruges qe lidh pronen nr.99 Reparti Usharak nr.5011/45, Surrel me rrugen nacionale”, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “2N” shpk ka deklaruar mjetet Eskavator me goma me targë ALMT95, Kamion me targë AA991IN, Rrul (Kompresor me vibrim) me Nr. Fature 29/2024 datë 02.05.2024, Asfaltoshtruese Nr. Rep: 8779 Nr. Kol:4190, Grejder me nr shasie 28006610, Autobitumatriçe me targë AA506PU, Autobot Uji me targë AA264TV, Kamion me targë AA561UV, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me object: “Rehabilitimi i rrugeve Hamide Dalipi, Ismail Klosi dhe degezimet e tyre”, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.

7. Operatori Ekonomik “VELLEZERIT HYSA” shpk

Operatori ekonomik “Vëllezërit HYSA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.13 ku është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Për materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmiteti CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, dokumentacioni i dorëzuar për skeda teknike dhe katalog per materialet tuba, për materialet elektrike, për bojrat dokumentacioni si certifikatat, skedat dhe kataloge janë dokumente të paraqitura vetëm në gjuhë të huaj dhe të papërkthyer në gjuhën shqipe, cka bie në kundërshtim me nenin 24, pika 2, paragrafi i dytë, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) ku përcaktohet “Në procedurat e prokurimit nën kufinj të lartë monetar, gjuha e përdorur është gjuha shqipe” si dhe dokumentet standard të tenderit “Njoftimi i kontratës, ”Seksioni 4, pika 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X.

Operatori ekonomik “Vëllezërit HYSA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.5, ku përcaktohet se: “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht: - 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Transport)”... Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “Vëllezërit HYSA” shpk nuk ka deklaruar inxhinier ndërtimi, Profili Transport, cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, Kriteret të Vecanta të Kualifikimit, të Dokumenteve Standarde të Tenderit

8. Operatori Ekonomik “PEPA GROUP GROUP” shpk

Operatori ekonomik “PEPA GROUP” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...” Autobitumatriçe cope 1, Grejder cope 1, Rul (Kompresor me vibrim) cope 2... gërma g) ku përcaktohet se: “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara

vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “PEPA GROUP” shpk ka deklaruar mjetet Autobotmatrice me targë AA456KK, Autobot uji me targë AA635NE, Grejder AIMT87, Eskavator me goma me targë AIMT86, Fadrome me targë ACMT72, Rul (Kompresor me vibrim) me fat Nr.3 datë 23.01.2015, Asfaltoshtuese nr shasie 47009..etj, mjete të cilat rezultojnë të angazhuara në kontratën me objekt: “Ndërtimi i ambjenteve të shërbimeve brenda zonës “TEDA”, me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “PEPA GROUP” shpk ka deklaruar mjetet Autobot uji me targë AA635NE, Eskavator me goma me targë AIMT8...etj, mjete të cilat rezultojnë të angazhuara në kontratën me objekt: “Ndërtimi i qendrës “TEN”, me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.

9. Operatori Ekonomik “PE – VLA - KU” shpk

Operatori ekonomik “PE - VLA - KU” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.13 ku është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Për materialet e kerkuara OE duhet të paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, dokumentacioni i dorëzuar për skeda teknike dhe katalog për materialet elektrike dhe bojrat dokumentacioni si skedat dhe kataloge janë dokumente të paraqitura vetëm në gjuhë të huaj dhe të papërkthyer në gjuhën shqipe, cka bie në kundërshtim me nenin 24, pika 2, paragrafi i dytë, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) ku përcaktohet “Në procedurat e prokurimit nën kufinj të lartë monetar, gjuha e përdorur është gjuha shqipe” si dhe dokumentet standard të tenderit “Njoftimi i kontratës, ”Seksioni 4, pika 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X. Operatori ekonomik “PE - VLA - KU” shpk nuk përmbushin Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.15 ku është kërkuar se: “Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit e cila duhet të përmbajë kodin 17.09.04. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezultoi se operatori ekonomik “PE - VLA - KU” shpk ka paraqitur Licensën 3.II B me nr. LN-0539-05-2020 e cila është licencë e lëshuar për transport të mbetjeve jo të rrezikshme, cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.15, të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ku është përcaktuar kërkesa për disponim të Licencës për “Grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta”.

Operatori ekonomik “PE - VLA - KU” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.16, ku përcaktohet: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)” gërma (f) ku përcaktohet; “Për mjetet që sipas përcaktimeve ligjore të qarkullimit rrugor nevojitet targa, leje qarkullimi...etj. Operatori ekonomik duhet të deklarojë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në rubriken përkatëse të dhënat për mjetet e kërkuara në shtojcën 8....”. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit rezultoi se operatori ekonomik “PE - VLA - KU” shpk në përmbushje të kërkesës për disponimin e mjeteve me qera apo në pronësi, për mjetet Fadromë, Eskavator me goma dhe Kamion me vinc deri në 5 ton nuk ka deklaruar të dhënat si targa e mjetit, nr e lejes së qarkullimit dhe nr e shasisë sipas formatit të kërkuar në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimi, Deklaratën C,

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.16, të Kapacitetit Teknik, Kriteret të Veçanta të Kualifikimit, të Dokumenteve Standarde të Tenderit

10. Operatori Ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” shpk

Operatori ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” shpk nuk përmbushin Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.15 ku është kërkuar se: “Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit e cila duhet të përmbajë kodin 17.09.04. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezulton se operatori ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” shpk ka paraqitur Licensën 3.II B me nr. LN-7433-06-2019 e cila është licencë e lëshuar për transport të mbetjeve jo të rrezikshme, cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.15, të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ku është përcaktuar kërkesa për disponim të Licencës për “Grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta.

11. Operatori Ekonomik “MARVELS”S Construction Group SHPK

Operatori ekonomik “MARVELS”S Construction Group” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate drejtuesin teknik (inxhinier ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:a)Librezë pune; b)Kontratë pune e vlefshme; c)Diplomë”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “MARVELS”S Construction Group” shpk ka deklaruar si drejtues teknik të punimeve me kohë të plotë në kantier punonjësen me inicialet M.B, e cila rezulton të jetë e angazhuar në kontratën me objekt: “Rikualifikim Blloku që kufizohet nga rrugët “Haxhi Xhuzi” – “Rreze Drite” – “Halil Hoxha”, me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare

Operatori ekonomik “MARVELS”S Construction Group” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...” Autobitumatrice cope 1, Grejder cope 1, Rul (Kompresor me vibrim) cope 2... gërma g) ku përcaktohet se: “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “MARVELS”S Construction Group” shpk ka deklaruar mjetet Autobitumatrice me targë AA230UL, Autobot uji me targë LA9619A, Fadrome me targë LA8501A, Grejder me nr shasie 89J909F, Rul (Kompresor me vibrim) me fat Nr.25 datë 28.02.2025, Asfaltoshtuese nr shasie 1804, Eskavator me goma me targë AGMT88....etj, mjete të cilat rezultojnë të angazhuara në kontratën me objekt: “Rikualifikim Blloku që kufizohet nga rrugët “Haxhi Xhuzi” – “Rreze Drite” – “Halil Hoxha”, me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.

12. Operatori Ekonomik “LIQENI VII” Shpk

Operatori ekonomik “LIQENI VII” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.9 dhe 2.3.10 ku është kërkuar: “Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tij personel të

kualifikuar/certifikuar për 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma

ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave"... dhe “Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: -1 (një) punonjës i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve te Ndërtimit /Inxhinier Materialeve ose Operatori Ekonomik...”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “LIQENI VII” shpk është mbështetur te subjekti mbështetës “SARDO” Shpk për 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” dhe për 1 (një) Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve te Ndërtimit /Inxhinier Materialeve, duke u mbështetur në më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 90, pika 2, paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ku përcaktohet se: “Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “ADDON” shpk & “BLERIMI” shpk me adresë: Tiranë,Rr. “Memo Meto”, Pallati 59/7, Apartamenti 9

Adresa: Elbasan, Shirqjan, Mjekes, Fshati Mjekes, Zona Topcias, Rr.Elbasan-Cerrik, Km.4”, me vlerë totale prej: **67,645,507.50** (gjashtëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.